



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut  
Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

---

Tiranë më 20 shtator 2007

## NJOFTIM PËR SHTYP

### KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT TRAJNON VËZHGUESIT E TIJ PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË PJESSHME, 23 SHTATOR 2007

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve akreditoi 20 vëzhgues afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, të cilët do të vëzhgojnë procesit të votimit dhe atë të numërimit të votave në zgjedhjet parlamentare të pjesshme për zonën 31 në Tiranë, që do të zhvillohen me 23 shtator 2007,

Pas akredimit të vëzhguesve nga KQZ-ja., më **19 shtator 2007**, KShH zhvilloi trajnimin e tyre lidhur me çështje të tilla si: kodi zgjedhor dhe ndryshimet e tij, udhëzimet e KQZ-së, metodologjia e vëzhgimit të procesit zgjedhor dhe mënyrën e raportimit. Pjesë e trajnimit ishin roli i vëzhguesit, cilësitë e tij, mënyra e paraqitjes së vërejtjeve në komision, në rast nevojë dhe raportimi i rezultateve të vëzhgimit.

Në mënyrë të veçantë, vëzhguesit e Komitetit Shqiptar i Helsinkit do të përqëndrojnë vëmendjen e tyre në monitorimin e procesit të votimit dhe të numërimit të votave.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga vëzhgimet, KShH, sipas rastit, do të dalë me deklaratat ose do të adresojë problemet në institucionet përkatëse dhe në përfundim të procesit zgjedhor do të shprehet mbi ecurinë e zgjedhjeve dhe nivelin e respektimit të standarteve për zgjedhje të lira, të ndershme dhe demokratike.